

DITARI MUJOR

JANAR 2025

12,466,038 NUMRI I VIZITORËVE TË HUAJ NË VITIN 2025



Numri i vizitorëve të huaj arriti 12,466,038, (+6.6% krahasuar me 2024), ndërsa Kosova, si tregu kryesor rajonal, kontribuoi me 4,662,571 vizitorë (+5.3%). Të ardhurat nga turizmi për 9-mujorin 2025 arritën 4.4 miliardë Euro, +14.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Vizitat në sitet e trashëgimisë kulturore u rritën me 1,523,587 vizitorë (+15.86%), ndërsa ndërhyrjet për restaurim dhe investimet në monumente kulturore shënuan rritje rekord (+309% projekte, +363% investime).

3,500 NGJARJE KULTURORE TË ORGANIZUARA NË VITIN 2025

Në fushën e kulturës, u mbështetën 277 projekte artistike (+37% krahasuar me 2024), u organizuan 3,500 ngjarje kulturore (+52%), me 600,000 spektatorë dhe 885 artistë shqiptarë u promovuan në 142 aktivitete në 18 shtete. Gjithashtu, u zhvilluan 862 aktivitete kulturore me karakter kombëtar dhe rajonal, duke rritur punësimin, krijimtarinë, artizanatin dhe promovimin e destinacioneve, si dhe duke forcuar imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë.



RIKTHEHEN 10 IKONA TË VJEDHURA NË KISHËN E LABOVËS SË KRYQIT



Dhjetë ikona me vlerë të jashtëzakonshme kombëtare, të vjedhura nga kisha “Fjetja e Shën Mërisë” në Labovën e Kryqit, i janë rikthyer Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë pas 14 vitesh mungesë. Autoritetet konfirmojnë se ky bashkëpunim me komunitetet fetare do të vijojë për gjetjen dhe rikthimin e objekteve të tjera të humbura, në kuadër të angazhimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare. Rikuperimi u bë i mundur falë bashkëpunimit institucional të suksesshëm me Policinë e Shtetit dhe mes Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

SHQIPËRIA SPIKATET NË FITUR 2026 NË MADRID SI DESTINACION GJITHËVJETOR DHE AUTENTIK

Në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit FITUR 2026 në Madrid, Shqipëria prezantoi standin e saj “Albania All Senses”, duke ofruar përvoja autentike turistike dhe kulturore përmes degustimeve, performancave live, artizanatit dhe teknologjisë VR. Interesi i vizitorëve dhe profesionistëve të turizmit ishte jashtëzakonshëm, me takime zyrtare dhe bilaterale me kompani si KPMG, Transat, Grupo Piñero dhe investitorë të tjerë, si dhe me institucione ndërkombëtare si UN Tourism, për të diskutuar zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, promovimin e destinacioneve kulturore dhe investimet strategjike.



Shqipëria u vlerësua si destinacion gjithëvjetor, konkurrues dhe i hapur për partneritete të qëndrueshme, ndërsa takimet me autoritete spanjolle dhe përfaqësues të medias prestigjioze, si Forbes Travel, La Razón dhe Mallorca Diario, konfirmuan rritjen e interesit për vendin tonë. Stenda shqiptare u kthye në një pikë qendrore takimi për vizitorë dhe profesionistë, duke përçar mikpritjen, diversitetin natyror dhe kulturor të vendit dhe duke forcuar imazhin e Shqipërisë si një destinacion me potencial të jashtëzakonshëm turistik.

FSHF PREZANTON STRATEGJINË “VISION TO VICTORY 2026–2030”



Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit mori pjesë në linçimin e strategjisë së re të Federatës Shqiptare të Futbollit “Vision to Victory 2026–2030”. Një plan ky që synon pjesëmarrjen masive, zhvillimin e talenteve, infrastrukturën, edukimin dhe investimin afatgjatë. Strategjia e sheh futbollin jo vetëm si garë sportive, por si instrument për përfshirje sociale dhe përmirësim të cilësisë së jetës, duke lidhur komunitetet, akademitë dhe ekipet kombëtare në një vizion të përbashkët. Pjesë e këtij modernizimi është edhe zhvillimi i platformave digjitale si FSHF TV, që afron futbollin me publikun dhe brezat e rinj përmes transmetimeve, emisioneve dhe kampionateve të moshave.

HAPEN THIRRJET PËR MBËSHTETJE FINANCIARE 2026 NË TURIZËM, KULTURË DHE SPORT

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka hapur thirrjet për mbështetje financiare për vitin 2026, të dedikuara ngjarjeve kulturore dhe turistike, programeve kulturore si dhe projekteve në fushën e sportit. Thirrja për evente kulturore dhe turistike synon promovimin e Shqipërisë si destinacion kulturor e turistik, me një fond total prej 190 milionë lekësh, ndërsa thirrja për organizatat kulturore mbështet programe kulturore vjetore, projekte artistike, edukim përmes artit dhe trashëgimi kulturore, me fond total 60 milionë lekë. Gjithashtu është hapur thirrje dhe për projekte në fushën e sportit, për KOKSH-in, Olimpikun Special Shqiptar, Federatat Joolimpike dhe Fondacionet Sportive.



HARTA E RRALLË E VITIT 1455 E BARTOLOMEO PARETOS VJEN NË MUZEUN KOMBËTAR “GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU” NË KRUJË

Muzeut Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Krujë i është shtuar harta origjinale e Bartolomeo Paretos, e vitit 1455, si një pasuri me vlerë kombëtare dhe evropiane; një nga dëshmitë më të rralla të hartografisë evropiane të shekullit XV.

Harta vendos emrin e Skënderbeut si toponim në qendër të Ballkanit dhe dëshmon rëndësinë e figurës së tij në oborret mbretërore evropiane dhe të botës së krishterë.

Ekzemplari, i certifikuar sipas standardeve shkencore më të larta, tashmë ekspozohet për publikun, studiuesit dhe brezat e rinj, duke pasuruar trashëgiminë kulturore dhe historike shqiptare dhe duke vendosur historinë e vendit tonë në kontekstin e saj evropian.



SHKODRA, MODEL I RI I ZHVILLIMIT KULTUROR DHE TURISTIK TË INTEGRUAR



Shkodra ishte në fokus të dy takimeve të rëndësishme mes Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Kryetarit të Bashkisë Shkodër, Benet Beci, ku u diskutua një vizion i unifikuar për zhvillimin kulturor dhe turistik të qytetit. Ky vizion ndërthur valorizimin e trashëgimisë kulturore me turizmin, mobilitetin e qëndrueshëm, infrastrukturën moderne dhe menaxhimin e përgjegjshëm të bregdetit. Në qendër të bisedimeve ishte projekti strategjik “Porta e Alpeve”, që synon ta pozicionojë Shkodrën si hyrjen kryesore drejt Alpeve Shqiptare, si dhe zbatimin e një modeli të ri për menaxhimin e plazheve dhe bregdetit.

NIS KOORDINIMI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E SEZONIT TURISTIK 2026

Nën drejtimin e Kryeministrit Edi Rama, u zhvillua një takim koordinues me ministrat respektive dhe kryetarët e bashkive nga e gjithë Shqipëria, për të reflektuar mbi rezultatet e shkëlqyera të vitit 2025 dhe për të planifikuar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe menaxhimin e sezonit veror 2026. Shifrat rekord të vizitorëve, rritja e të ardhurave, investimet në infrastrukturë dhe energjia në evente kulturore tregojnë efektin e punës së përbashkët dhe vizionit që po e vendos Shqipërinë si destinacion konkurrues në sferën ndërkombëtare.

Fokus është jo vetëm rritja e turistëve, por edhe cilësia, standardet e larta, menaxhimi i qëndrueshëm i destinacioneve dhe përfitimet reale për komunitetet lokale, duke forcuar bashkëpunimin mes qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor si motor për zhvillim ekonomik dhe social.



PREZANTOHET RAPORTI STRATEGJIK PËR TRANSFORMIMIN E GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE

Me ekipin e Muzeut MAXXI u prezantua Raporti Strategjik për Galerinë Kombëtare të Arteve, i cili adreson sfidat institucionale, modelet bashkëkohore të menaxhimit, një strukturë të re organizative dhe një model financiar për qëndrueshmëri afatgjatë. Procesi do të shoqërohet me trajnime për stafin dhe zhvillim programesh kulturore për të rritur kapacitetet dhe impaktin publik të institucionit. Paralelisht me përmirësimin e infrastrukturës, Galeria do të adoptojë një qasje të re gjithëpërfshirëse: pasurim të

koleksionit përmes politikave të reja të blerjes, forcim të restaurimit e konservimit, programe kuratoriale bashkëkohore, bashkëpunime ndërkombëtare dhe fokus të veçantë të edukimi i të rinjve, duke e kthyer Galerinë në një hapësirë dinamike mësimi, dialogu dhe krijimtarie.



INAUGUROHET KUBFRANCESHKODRA, HAPËSIRA DIGJITALE PËR ARTIN DHE EDUKIMIN



KubFranceShkodra, një hapësirë e re kulturore digjitale që lidh artin, teknologjinë dhe edukimin në një format bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës u inaugurua në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi", me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Shqipëri dhe partnerëve institucionale. Si pjesë e rrjetit ndërkombëtar Micro-Folie / La Villette, projekti synon të ofrojë akses në trashëgiminë kulturore ndërkombëtare, të nxisë krijimtarinë dhe angazhimin e të rinjve, si dhe të forcojë edukimin kulturor përmes përvojave digjitale inovative.